

URDHËR
Nr. 28, datë 13.3.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E SHKELJEVE TË TJERA TË LIGJIT NR.9367, DATË 7.4.2005 “PËR
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE
PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 42, pika 2, nenit 44, germa “e”, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, dhe të rregullores së brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

URDHËROJ:

Përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, që konstatohen gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, të cilat do të sanksionohen sipas masës së parashikuar në pikën 1, germa “e” të nenit 44 të këtij ligji, në rastet kur:

1. Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, i ngritur në zbatim të nenit 41/2, germa “b”, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, nuk dokumenton dhe regjistron në regjistrin e konfliktit të interesit të dhënat e kërkuara në nenin 11 të këtij ligji, lidhur me rastet e konfliktit të interesave në institucionin publik përkatës.

2. Zyrtari, eprori apo struktura përgjegjëse në institucionin epror, në kundërshtim me kërkesat e nenit 37/9 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, nuk njofton në kohë Inspektoratin e Lartë, mbi masat e marra rast pas rasti në kompetencë të tyre, për trajtimin apo zgjidhjen konfliktit të interesit sipas përcaktimit të bërë nenin 37 të këtij ligji.

3. Eprori, apo çdo zyrtar tjetër, nuk bën prezent pranë autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit, informacionin që disponon lidhur me interesat privatë, të cilat bëhen shkak për konflikt të interesit për zyrtarët.

4. Struktura përgjegjëse në institucionin publik, gjatë mbledhjes së informacionit për interesat privatë të zyrtarëve, nuk ruan konfidencialitetin e të dhënave sipas përcaktimit të pikës 2/1 të nenit 10 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar.

5. Vërtetohet se eprori ka ushtruar kompetenca administrative me efekte ndëshkuese ndaj subjektit/zyrtarit, për shkak të informacionit të dhënë nga ky i fundit, lidhur me ekzistencën e interesave privatë të eprorit apo çdo zyrtari tjetër në institucionin publik.

6. Titullari dhe autoriteti përgjegjës nuk përmbushin detyrimin e përcaktuar në nenin 46 të ligjit, për nxjerrjen e akteve nënligjore për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike.

7. Zyrtari/struktura përgjegjëse e institucionit publik, sipas përcaktimit të bërë në ligjin organik dhe aktet nënligjore respektive, nuk ndërmerr masat e nevojshme për rregullimin e pasojave juridike të akteve të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesave, sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 40/1, pika 1 germa “a”, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

8. Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave nuk përmbush në afatet e caktuara detyrimet ligjore të përcaktuara në nenin 42/3 i këtij ligji, si dhe detyrat e lëna nga Inspektorati i Lartë, për problematikat që rezultojnë nga kontrollet e ushtruara mbi veprimtarinë dhe zbatimin e ligjit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Ganaj